



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 218 prot.

Shkodër, më 05/08/2020

VENDIM

Nr. 34 datë 05/08/2020

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 05.08.2020, shqyrtoi ankesën e z.Adem Bekteshi të datës 03.08.2020, me objekt: "Ankesë dhe kërkesë për rinumërim votash dhe kërkesë për pavlefshmmëri". KIZ pasi shqyrtoi këtë ankesë,

VËREN

Z.Adem Bekteshi ka depozituar në KIZ, kërkesën ankimore me objekt "Ankesë dhe kërkesë për rinumërim votash dhe kërkesë për pavlefshmmëri", e datës 03.08.2020, e cila është regjistruar në Regjistrin e Korrespondencës së KIZ, me nr. 217 prot., me datë 04.08.2020.

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në USH, përkatësisht me Vendimin nr. 23 datë 30.07.2020 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për Rektor të USH-së dhe me Vendimin nr.29, datë 03.08.2020 për shpalljen e fituesit të Rektorit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Sipas çdo lloj interpretimi të zgjeruar, të kuptimit të afatit, bazuar në nenin 36 pika 3 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në USH", afati i fundit për dorëzimin e ankimeve, mund të ishte deri në orën 16:00 të datës 02.08.2020.

Bazuar në nenin 36 pika 1, 2, dhe 3, z.Bekteshi si kandidat dhe askush në emër të tij, nuk ka bërë ankesë brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e zgjedhjeve në USH, në lidhje me rezultatet e tabelave përmbledhëse të ardhura nga të gjitha KZF-të, të datës 30.07.2020. Në këto kushte, KIZ e vlerëson jashtë afatit kërkesën në fjalë, e për pasojë ankesa e tij nuk mund të merret parasysh nga KIZ.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 6 pika 2, germa h dhe i, nenin 7, pika 7 germa g, nenin 36 pika 1, pika 2, pika 3, dhe pika 5, të Rregullorës "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në USH",



VENDOSI:

1. Mospranimin e shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga z.Adem Bekteshi me objekt “Ankesë dhe kërkesë për rinumërim votash dhe kërkesë për pavlefshmmëri” e datës 03.08.2020, me nr.217 prot., me datë 04.08.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretare
Eugena Bisha



Anëtarë

Kryetar
Gasper KOKAJ

Arian Gjura

Fatjon Nurja

Sebastjan Mjekaj

Ingrit Tirana

Marsel Nilaj

Megan Krahi